

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit O.C. nga fsh. Komuna e Istogut , të cilin e përfaqëson me autorizim av.A. N., nga Peja, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K. e R.” në Prishtinë, të cilën e përfaqëson A. M., me autorizim, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3386/2012 datë 17.11.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15 tetor 2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pjesërisht pranohet revizioni i paditësit, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.3386/12 i dt.17.11.2014 dhe ai i Gjykatës Komunale në Istog, C.nr.125/09 i dt.2.11.2011,në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ashtu që DETYROHET e paditura t’i paguajë paditësit në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 4500€,ndërsa, përkitazi me kompensimin e dëmit jo material për shëmtim trupor, mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Pjesët tjera të dispozitivit të aktgjykimeve mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m i

Me pjesën e parë të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Istog C.nr.125/09 të dt.2.11.2011,është miratuar pjesërisht padia e paditësit dhe detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit jo material për aksidentin e komunikacionit të shkaktuar me

dt.7.05.2009, paditësit t'ia paguajë satisfakcionin në shumë prej 11.600€ dhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 2800€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 6400€, për frikë 2000€, për shëmtim 400€. Me pjesën e dytë të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditësit në emër të dëmit material për kujdesin dhe ndihmën e huaj t'i paguajë shumë prej 160€, për ushqimin e përforcuar 160€, për shpenzimet e mjekimit 120€, e kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë, për mjetet e deponuara pa afatizim dhe destinim të caktuar, sipas normës 3.5% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 1.06.2009 e deri në pagesën definitive. Me pjesën e tretë të dispozitivit, shumat përtej shumës së gjykuar në emër të dhimbjeve fizike 700€, zvogëlim të aktivitetit jetësor 1600€, frikës së përjetuar 500€, shëmtimit 100€, për dëmin material për kujdesin dhe ndihmën e huaj 40€, ushqim të përforcuar 40€ dhe shpenzimet e mjekimit 30€, i ka refuzuar si të pabazuara dhe me pjesën e fundit, ka detyruar të paditurën që paditësit t'i paguajë shpenzimet kontestimore në shumë prej 1.256€ të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dt. e pranimit të aktgjykimit me kërcënim përmbarimi.

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3386/12 dt.17.11.2014, është miratuar pjesërisht ankesa e së paditurës, kurse dispozitivi nën I i aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Istog C.nr.125/09 dt.2.11.2011 është ndryshuar në pjesën që ka të bëjë me kompensimin për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit dhe në këtë pjesë është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa, pjesën tjetër të dispozitivit nën I, e ka vërtetuar. Një pjesë të dispozitivit nën II, që ka të bëjë me kamatën ,po ashtu e ka ndryshuar, duke detyruar të paditurën që shumat e gjykuara si në pjesën nën I dhe II, t'ia paguajë paditësit të shtuara për kamatën përkatëse sipas përqindjes që e zbatojnë bankat komerciale në deponimet e kursimit të afatizuar pa destinim të caktuar mbi një vit e cila kamatë llogaritet nga dt.6.10.2011 deri në pagesën defintive. Dispozitivin nën III ,e ka ndryshuar ashtu që ka vendosur që në pjesën përtej shumës së gjykuar ,kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar dhe në pjesën e mbetur ,ankesën e ka refuzuar si të pabazuar, kurse, aktgjykimin e ankimuar e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së dytë, përkatësisht pjesës që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit, në afat ligjor, ka paraqit revizion paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të

anulohet pjesërisht aktgjykimi i shkallës së dytë dhe për këtë pjesë lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 7.5.2009 rreth orës 18,30 minuta në rrugën magjistrale Pejë-Mitrovicë, në Komuna e Istogut, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në të cilin kanë marrë pjesë automjeti i markës "... " me targa ... të cilën e ka drejtuar B. R., automjeti i të cilit është siguruar nga auto-përgjegjësia te e paditura. Në këtë aksident ka marrë pjesë edhe paditësi në cilësinë e këmbësorit. Sipas konstatimit të ekspertit të komunikacionit Kastriot Gashi, fajtor primar për shkaktimin e aksidentit është shoferi i automjetit të sipër përmendur, i cili nuk ka respektuar kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes në atë pjesë të rrugës, kurse fajtor sekondar është këmbësori- paditësi sepse nuk i ka kushtuar kujdes kalimit nga njëra anë në anën tjetër të rrugës, shprehur në përqindje 80% fajësia e të siguarit të së paditurës dhe 20% e këmbësorit – paditësit. Në këtë aksident sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertëve mjekësorë – ortopedit dr. N. M., ortoped –traumatolog dhe neuropsikiatrit dr.M. H., rezulton se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, lëndime të kokës – tronditje të trurit, plagë prerëse – ndrydhëse të kokës dhe qafës në anën e majtë dhe gërvishje të fytyrës. Po ashtu pati thyerje të dyfishtë të nën gjurit të djathtë dhe si pasojë e aksidentit ka mbetur me invaliditet të përhershëm trupor prej 15%, ka pasur dhimbje posaçërisht të larta në kohëzgjatje prej 2 orësh, të intensitetit të lartë 2 ditë, të mesëm 4 javë, të vogël edhe sot e kësaj dite, frikë posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej 2 orësh, të intensitetit të lartë 2 ditë , të mesëm 2 javë, shëmtim të shkallës së lehtë, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar 2 muaj , ndihma e huaj ka qenë e nevojshme prej 3 muaj, terapi fizikale në formë stacionare 2 herë në vit nga 15 ditë.

Në bazë të kësaj gjendjeje faktike të vërtetuar , gjykata e shkallës së parë pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore përkitazi me kompensimin e dëmit jomaterial, zvogëlimin të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor, e ka ndryshuar

aktgjykimin e shkallës së parë duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për këtë pjesë, po ashtu ka vendosur edhe për pjesët tjera të aktgjykimit të shkallës së parë, si në dispozitiv të aktgjykimit të saj të përshkruar më lartë, por që këto pjesë të tjera nuk janë goditur me revizion.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimi i shkallës së dytë me të cilin është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë, duke refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor, është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 200 i LMD-së. Kështu sepse, nga provat e zhvilluara dhe vlerësuara e sidomos nga ekspertiza e ekspertit mjekësor të ortopedisë, është vërtetuar se paditësi në aksidentin e komunikacionit, veç tjerash, ka pësuar edhe dëm jo material që manifestohet si shëmtim trupor i shkallës së lehtë dhe zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 15%. Në anën tjetër, përcaktimi i kompensimit (satisfaksionit) për dëmin jo material paraqet zbatim të së drejtës materiale. Në kuptim të nenit 200 të LMD, gjykata duhet të kujdeset lidhur me rëndësinë e së mirës së cenuar dhe për qëllimin të cilit i shërben caktimi i kompensimit, por, edhe lidhur me atë që të mos favorizohen tendencat e palës tjetër, të cilat nuk janë në përputhshmëri me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, edhe shuma e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë për shpërblimin e dëmit në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor paditësit prej 6.400 €, është e lartë dhe nuk është në përputhje me kriteret e parapara me dispozitën e sipër përmendur ligjore, për të cilën arsye edhe aktgjykimi i shkallës së parë lidhur me këtë pjesë është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Për arsyet e sipërpërmendura pranohen si pjesërisht të bazuara pretendimet e revizionit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale përkitazi me shpërblimin e dëmit për format e dëmit të lartpërmendur, prandaj, kjo Gjykatë, aktgjykimet e instancave më të ulëta i ndryshoi ashtu që në emër të dëmit jo material për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditësit për shkallën prej 15%, i caktoi shumën e shpërblimit shumën prej 4.500 €, ndërsa, përkitazi me shpërblimin e caktuar nga gjykata e shkallës së parë për shëmtimin trupor në shumë prej 400 €, e la në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë. Kështu, ngase këto shuma të caktuara janë adekuate, ekuivalente dhe në përputhje me natyrën, peshën dhe shkallën e lëndimeve të pësuar, të cilat shuma nuk kanë qëllim fitimprurës (lukrativ) por vendosjen e një ekuilibri psikik dhe si një satisfaksion për paditësin.

Pjesët tjera të dispozitivit të aktgjyqimeve përkatëse, mbeten të pashqyrtuara ngase nuk janë goditur me revizion.

Nga sa u theksua më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.125/2015 datë 15 tetor 2015

Kryetar i kolegjit,
Mr.sc. Muhamet Rexha

